

**STATUT**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"DDS Global" SHPK**

Sot më datë 19.10.2023, unë Sema Ramiz Pekin, shtetase Turke, e datëlindjes 23.02.1982, identifikuar nga Numri i Identitetit në Turqi 15536263034, Pasaporta me Nr. U298964441, lindur në Edirne Merkez, e banuese në Şükrüpaşa Mah. Lefkoşa Sokak No.4, Ecem Residence Daire 46 Kat. 11, Edirne Merkez, Istanbul, Turkiye, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, bazuar në vullnetin tim të lire dhe në përputhje me ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", vendosa hartimin e Statutit të Shoqërisë, në bazë të këtij ligji.

**KREU I**  
**OBJEKTI, EMËRTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK**

**Neni 1**  
**Objekti i Shoqërisë:**

1. Shoqëria do të kryejë çdo aktivitet të nevojshëm tregtar në fushën e Tregtisë së jashtme, Tregtisë Ndërkombëtare të Ushqimit, Konsulencës dhe Trajnimit në Arsim, Shërbime të Konsulencës së Projekteve të Bashkimit Europian, Blerja dhe Dizajnimi i softuerëve dhe aplikacioneve të ndryshme.
2. Export -Import. Blerjeve të mallrave për shitje me pakicë dhe shumicë; brokerimi, organizimi i kurseve të trajnimit, seminareve dhe konferencave, mbështetje teknike dhe organizative për organizimin e kurseve të trajnimit, seminareve dhe konferencave; aktiviteteteve reklamuese dhe promovuese, veprimtari ekonomike dhe konsulenca organizative, si dhe kryerja e studimeve mbi tregun dhe shërbime mbështetëse për shitjet:
3. Shoqëria do të kryejë çdo aktivitet të nevojshëm tregtar në ofrimin dhe shitjen e shërbimeve profesionale në fushën e trajnimit, organizimin e eventeve, konferencave, seminareve dhe ekspozitave, menaxhimin e eventeve që kanë të bëjnë me krijimin dhe zhvillimin e aktiviteteteve të vogla dhe/ose në shkallë të gjerë kombëtare ose ndërkombëtare si individuale ashtu dhe per korporatat, siç janë festivalet, konferencat, ceremonitë, festat zyrtare, koncertet, kongreset apo konventat, konsulenca biznesi, konsulenca ekonomike, konsulencë në fushën mjedisore, si dhe për çdo eveniment klasik që lidhet me biznesin.
4. Kryerja e çdo aktiviteti tjetër tregtar në fushën e biznesit dhe kryerja e çdo veprimtarie ekonomike në Shqipëri ose jashtë vendit që ka një lidhje direkte ose indirekte me qëllimin e mësipërm të kompanisë dhe që është e nevojshme për promovimin e biznesit dhe arritjen e objektivave të shoqërisë.

5. Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari tjetër të lejuar nga ligji dhe legjislacioni në fuqi.
6. Ortaku i vetëm mund të vendosë ndryshimin, shtimin ose pakësimin e aktiviteteve që përbëjnë Objektivin e Shoqërisë, brenda kufinjve të lejuara nga legjislacioni në fuqi.

## **Neni 2**

### **Emërtimi dhe Selia e Shoqërisë:**

- 2.1. Ortaku i vetëm vendosi që Shoqërinë ta emërtojë "DDS Global" Shpk.
- 2.2. Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën Njësia Administrative Nr.9, Rruga e Dibres, Nd.91, H.4, Kodi Postar 1017. Kjo adresë është e përkohëshme për efekt regjistrimi deri në mbledhjen e parë të Asamblesë së Ortakut të vetëm dhe në fillimin e veprimtarisë së shoqërisë.

**E-mail:** semapekin@hotmail.com

**Tel:** ++ 90 532 173 55 65

- 2.3. Transferimi i selisë së shoqërisë bëhet me vendim të Asamblesë së Ortakut.
- 2.4. Shoqëria mund të hapë për nevojat e saj njësi dytësore si vendndodhje të saj pune ose shërbimi, Zyra përfaqësimi ose degë në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit. Vendimi merret nga Asambleja e Ortakëve.

## **Neni 3.**

### **Regjimi Juridik:**

- 3.1. Shoqëria është Shoqëri me Përgjegjesi të Kufizuar. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit, dhe legjislacionit në fuqi në Shqipëri, ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 3.2. Me vendim të tij Ortaku i vetëm mund të ndryshojë regjimin juridik të Shoqërisë, në të ardhmen nëse krijohen premisa më të favorshme për organizimin dhe funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Në këtë rast ortaku do të pershtasë Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqërisë, si dhe do të bëjë regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar në organet kompetente shqiptare ose të huaja.
- 3.3. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në organin kompetent ose në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me ligjin.
- 3.4. Shoqëria çel llogari bankare në monedhën e vendit ose në çdo lloj valute, në Bankat vendase ose të huaja me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së saj dhe përballimin financiar të aktivitetit të saj. Ortaku i Shoqërisë ose administratori i caktuar prej tij, depozitojnë specimentin e firmave të tyre origjinale në Bankat ku është çelur llogaria dhe veprimet apo transaksionet bankare mbi llogarinë bëhen nga titullari i llogarisë sipas rregullave bankare ose vendimit të shoqërisë.
- 3.5. Shoqëria do të ketë emblemën dhe vulën e saj. Forma dhe përmbajtja e saj përcaktohet nga Administratori i shoqërisë.

## **KREU II TË DREJTAT DHE DETYRAT, KOHËZGJATJA**

### **Neni 4**

#### **Të drejtat e Shoqërisë dhe të Ortakut:**

- 4.1. Shoqëria ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe të nënshkruajë kontrata të ndryshme në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.
- 4.2. Shoqëria gëzon të drejtën të krjojë pasuri materiale dhe intelektuale.
- 4.3. Shoqëria ka të drejtë të marrë pjesë si ortakë në shoqëri ose ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose të vendit të huaj.
- 4.4. Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqëror të derdhur dhe me të mirat e pasurisë së saj. Ajo në asnjë rast nuk përgjigjet për detyrimet personale të Ortakut dhe as ky i fundit nuk mban përgjegjësi personale për detyrimet që merr përsipër Shoqëria.
- 4.5. Ortaku ka të drejtë të marrë të gjitha të dhënat apo informacionet që kanë të bëjnë me veprimtarinë prodhuese, planet dhe projektet realizuese e tregtare të Shoqërisë, si bilanci, llogaritë ekonomike, etj.
- 4.6. Ortaku përballon humbjet e Shoqërisë vetëm dhe deri në kufirin e vlerës së kontributeve të tij në Kapitalin Themeltar.

### **Neni 5**

#### **Kohëzgjatja**

- 5.1. Kohëzgjatja e Shoqërisë është me afat të pacaktuar. Shoqëria mund të prishet në çdo kohë me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

## **KREU III**

### **KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT**

#### **Neni 6**

- 6.1. Kapitali themeltar është 100 000 (njëqind mijë lekë dhe është i ndarë në 1 kuotë me vlerë nominale, 100.000 lekë.
- 6.2. Ndarja e pjesëve në kapitalin themeltar është: Sema Pekin, 1 kuotë, përkatësisht 100% të kuotës. Zotëruesi i një kuote, gëzohet cilësinë si një ortak i vetëm.
- 6.3. Kapitali i Shoqërisë mund të shtohet ose të pakesohet sipas vendimeve që do të marrë Ortaku i Vetëm. Zvogëlimi i kapitalit përballohet prej ortakut në të njëjtën masë me pjesën e kapitalit të zotëruar prej tij.
- 6.4. Ky kapital nuk mund të jetë më i vogël se minimumi i përcaktuar me ligj.

### **Neni 7**

#### **Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar:**

- 7.1. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme midis ortakëve të Shoqërisë dhe personave të tjerë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri.

7.2. Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen nga ortaku/ortakët, personave të tretë, që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e ortakut të vetëm /ortakëve.

7.3. Transferimi i kuotave kushtëzohet nga e drejta e parablerjes se ortakeve nëse ka. Në një rast të tillë, ortaku që do të transferojë kuotat e tij të kapitalit duhet t'i njoftojë paraprakisht ortakët e tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigje dhe ose me "Leter Njoftimi" nepermjet adreses elektronike (në vijim "Njoftim"), për:

(a) numrin e kuotave të ofruara;

(b) emrin e blerësit/përfituesit;

(c) çmimin e rënë dakort për çdo kuotë, i përcaktuar në çdo rast në para, ose në vlerën në para në rast të një kundërshtëpërblimi tjetër të mundshëm (në rast shkëmbimi, kompensimi vullnetar, transaksioni, dhe çdo rast tjetër transferimi me shpërblim), ose vlerën e objektit të transferimit në rastin e transferimit pa shpërblim,

(d) modalitetet e pagesës;

(e) ftesen për të ushtruar të «drejtën e parablerjes. Afatet dhe kushtet e mundshme për të cilat është rënë dakort midis transferuesit të kuotave dhe blerësit/përfituesit nuk do të jenë detyruese për ortakët e tjerë të cilët do të ushtrojnë të drejtën e parablerjes. E drejta e parablerjes i referohet të gjitha kuotave të kapitalit ofruar për shitje.

7.4. Ortakët do të kenë në dispozicion 30 (tridhjetë) ditë nga marja e Njoftimit, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes.

7.5. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, presumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes. Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuotat e ofruara nga ortaku që transferon kuotat, do të ndahen nga ortaket pranues, në të njëjtën masë me kuotat që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.

8.6. Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat e ofruara në njoftim mund t'u transferohen të tretëve sipas çmimit të specifikuar në të.

## **KREU IV ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ORGANET KRYESORE**

### **Neni 8**

8.1. Shoqëria fiton personalitetin juridik nga data e regjistrimit të saj në organin kompetent, Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

8.2. Emërtimi i Shoqërisë Tregtare, emblema, NIPT-i, dhe adresa duhet të jenë të përmendura në të gjitha aktet dhe dokumentet që nxjerr kjo shoqëri dhe ju drejtohen të tretëve.

8.3. Organet kryesore të shoqërisë janë: Asambleja e Ortakëve e përbërë nga Ortaku i Vetëm ose Ortakët e tjerë nëse do të ketë në të ardhmen, dhe Administratori.

## **Neni 9**

### **Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë:**

Asambleja e Ortakëve është organi vendimarrës i shoqërisë. Ajo përbëhet nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë ose Ortakët e tjerë nëse do të ketë në të ardhmen, që është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë dhe vendimet e tij janë të detyrueshme për zbatim nga organet ekzekutive të shoqërisë.

Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Ortakëve ushtrohen nga Ortaku i Vetëm. Të drejtën e thirrjes së Asamblese e kanë Ortaku i Vetëm i Shoqërisë ose Administratori. Asambleja e Ortakëve thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike.

Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e duhet tu dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se shtatë ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.

### **Neni 9/1**

#### **Thirrja e Asamblesë së Ortakëve, Kuorumi dhe Vendimet:**

9.1. 1. Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit/ve. dhe/ose ekspertit kontabël (nëse është emëruar) si dhe të inventarit.

9.1. 2. Asambleja mund të thirret në çdo moment prej Administratorit me iniciativën e tij kur e gjykon të arsyeshme ose sipas kërkesës që do ti drejtohet Administratorit nga një ose disa prej ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar. Asambleja thirret nëpërmjet:

a) njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje.

b) Faksit, E-mail, Telefonit, etj:

c) Poste elektronike. Njoftimi me poste elektronike konsiderohet i kryer me kalimin e 10 (dhjete) diteve kalendarike nga nisja e njoftimit. Njoftimi për secilin ortak dërgohet në adresat respektive përshkruar në hyrje të aktit.

Lajmerimi do t'u dërgohet ortakëve, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara

9.1. 3. Ortaku mund të përfaqësohet në Asamble vetëm ose nëpërmjet një përfaqësuesi të autorizuar me prokurë të posaçme dhe duhet të marrin vendime vetëm për ato çështje që do të diskutohen në mbledhjen për të cilën ata kanë marrë të drejtën e përfaqësimit në prokurë.

9.1. 4. Mbledhjet e Asamblesë pasqyrohen në procesverbalin që mbahet me këtë rast, ndërsa vendimet nënshkruhen nga ortaku i vetëm.

Procesverbalet e mbledhjeve depozitohen dhe ruhen në selinë e Shoqërisë.

Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Ortakëve regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të korrigojnë apo të fshihen.

9.1. 5. Në mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve, nëse gjykohet nga drejtuesit e saj në rastet e duhura, me kërkesë të tyre, nisur edhe nga praktika

Perëndimore, mund të pranohet të jenë anëtar i asamblesë në administrimin e Shoqërisë, sekretar i asamblesë ose të kryejmë rolet e këshilltarëve të jashtëm një avokat, i cili duhet të adresojë për asamblenë drejtuese misionin, autoritetin dhe përgjegjësitë e asamblesë, përbërjen, si dhe kur takimet do të mbahen dhe mënyrën se si do të shkruhen dhe miratohen procesverbali i mbledhjeve, si dhe do të japë asistencë për përgatitjen e dokumentave të nevojshëm për nevojat e shoqërisë ose informacionin e nevojshëm për ligjet rregullatore në fusha të veçanta, përfshirë dhe ndryshimet e ligjit. Ftesa drejtuar avokatit për të qenë e pjesë e kësaj strukture i adresohet përmes administratorit të shoqërisë. Ai shpërblehet për pjesëmarrjen sipas tarifave standarde të aplikuara në këtë rast.

**9. 1. 6. Ortaku i Vetem i Shoqërisë ose ndryshe Asamblea e Ortakëve ka të drejtë të marrë vendime për çështjet e mëposhtme:**

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë.
- b) Ndryshimet e Statutit.
- c) Emerimin e shkarkimin e Administratorit.
- ç) Emerimin e shkarkimin e Likujduesve dhe të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.
- d) Përcaktimin e pagave ose të shpërblimeve për personat e përmendur në pikën "c" dhe "ç" dhe " " të këtij neni.
- dh) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratorët përfshirë përgatitjen e pasqyrave Financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- e) Miratimin e pasyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- ë) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit.
- f) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- g) Përfaqësimin e Shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- g) Riorganizimin/bashkimin/ndarjen dhe prishjen e Shoqërisë.
- h) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblese.
- i) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo Statuti.

**KREU V  
ADMINISTRIMI  
Neni 10**

10.1. Shoqëria do të administrohet nga 1 (një) Administrator i vetem, i cili mund të zgjidhet edhe jashtë Ortakëve të Shoqërisë.

10.2. Administratori emërohet dhe shkarkohet nga Ortaku i vetëm ose Asamblea e Ortakëve e shoqërisë.

10.3. Administrimi i Shoqërisë do bëhet nga Administratori, Zj. Sema Pekin.

10.4. Kohëzgjatja në detyrë e administratorit të Shoqërisë do të jetë 5 (pese) vjet, me të drejtë ripërtëritje në përfundim të mandatit.

10.5. Administratori i vetëm i ka të gjitha të drejtat, kompetencat e fuqitë për drejtimin e zakonshëm të Shoqërisë, me qëllim aritjen e objektivave të saj.

10.6. Administratori perfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët.

10.7. Administratori është përgjegjës, sipas rastit, ndaj Shoqërisë ose të treteve vetëm për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit apo për dëme të kryera gjatë ushtrimit të detyrës së tij.

#### **10.8. Kompetencat kryesore të administratorit në Shoqëri janë:**

- Kryen të gjitha veprimet e administrimit të përditshëm të veprimitarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga Ortaku i Vetëm.
- Përfaqëson Shoqërinë Tregtare në marrëdhënie me të tretët.
- Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentacionit të shoqërisë dhe të librave kontabël të Shoqërisë.
- Përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimitarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve i paraqet këto dokumente përpara Ortakut të Vetëm për miratim.
- Krijon një sistem sigurie dhe paralajmërimi në kohën e duhur për rreziqet dhe rrethanat që mund të kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimitarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë.
- Kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- Raporton përpara Ortakut të Vetëm ose Asamblesë së Ortakëve sipas rastit në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe për realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimitarinë e Shoqërisë Tregtare.
- Kryen detyra të përcaktuara në ligj dhe në Statut.
- Administrimin e pasurisë së Shoqërisë, duke përfshirë, pajisjet dhe mjetet, të ardhurat financiare, brenda caqeve të lejuara nga Asambleja e ortakëve ose Ortaku i Vetëm.
- Kryerjen e të gjitha veprimeve bankare në interes të Shoqërisë.
- Të përfaqësojë Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët në të gjithë veprimitarinë e saj pa kufizim dhe të mbrojë interesat e saj përpara çdo gjykate apo arbitrazhi, organi të administratës publike, të nënshkruajë çdo kontratë sipas kompetencave të tij në emër të Shoqërisë dhe të ndjekë zbatimin e tyre.
- Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm ligjorë për të kryer veprime të caktuara apo përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e shoqërisë.
- Ti propozojë Ortakut të Vetëm për miratim strukturën e aparatit administrativ të Shoqërisë dhe krijimin e organeve të tjera të domosdoshme për realizimin e veprimitarisë dhe objektivave të Shoqërisë.
- Ti propozojë Ortakut të Vetëm për miratim numrin e punonjësve të Shoqërisë, pagat dhe emërimin e shkarkimin e tyre.
- Të thërresë me inisjativën e tij në çdo moment mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve për çdo rast të paraqitur.

### **Neni 11 Marrëveshjet e ndaluara**

11.1. Administratorit ose Ortakut nuk u lejohe të kontraktojnë në çfarë do lloji forme qoftë, të marrin hua te Shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzanës apo të garantojnë në emër të saj

angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme. Kjo masë ndaluese zbatohet edhe ndaj perfaqësuesve ligjore të Ortakëve që janë persona juridikë.

11.2. Kjo masë zbatohet gjithashtu edhe ndaj bashkëshortëve, paraardhësve dhe pasardhësve të personave të cituar në paragrafin e parë të këtij neni, si dhe ndaj çdo personi ndërmjetës.

## **KREU VI**

### **VITI FINANCIAR, LLOGARITË VJETORE, NDARJA E FITIMEVE**

#### **Neni 12**

12.1. Çdo vit financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përgjashtimisht bën viti i parë, i cili fillon në datën e regjistrit të Shoqërisë. në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

12.2. Llogaritë vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e veçanta të hartuara nga administratori dhe eventualisht eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga Asamblea e Ortakut me shumicën e kërkuar nga Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtarët dhe Shoqëritë tregtare".

12.3. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore bëhet brenda 3 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

12.4. Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara.

12.5 Asamblea mund të vendosë zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtezakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, dividendit plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

#### **Neni 13**

#### **Kontrolli i Shoqërisë**

13.1. Kontrolli Shoqërisë kryhet nga një Ekspert Kontabël i Autorizuar, i emëruar nga Asamblea e Ortakut.

13.2. Eksperti Kontabël i Autorizuar garanton që llogarite vjetore të Shoqërisë janë të rregulta, të hartuara me sinqeritet, pasqyrojnë rezultatet e vitit të kaluar financiar, si dhe gjendjen financiare të shoqërisë. Ai verifikon librat e llogarive, si dhe fondet e Shoqërisë, kontrollon përshtatjen e kontabilitetit me të dhënat dhe në raportin e administrimit, kontrollon gjithë librat e llogarive, dokumentet kontabel dhe regjistrat e proces-verbaleve. Mund të aktivizojë ekspertë dhe bashkëpunorë të tjerë për të përballuar volumin e punës, por duke marrë më parë miratimin e Asamblesë së Ortakëve.

13.3. Shkarkimi i Ekspertit Kontabël të Autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si për emerimin e tij nga ana e Asamblesë së Ortakëve.

## **KREU VII**

### **PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE**

#### **Neni 14**

14.1. Shoqëria mund të prishet në çdo kohë dhe për çfarë do lloj shkak, si në rast falimentimi, privimi të së drejtave për të ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktorë të tjerë që nuk varen nga Ortaku.

14.2. Shoqëria hyn në fazën e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi, Asamblea e Ortavëve emëron një ose disa likuidatorë, të cilët i paraqesin atij raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të Likuiditetit dhe afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

14.3. Në fund të procesit të likuidimit, Asamblea e Ortakëve me vendim vendos mbi bilancin përfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmërisë së punës së likuiduesit, dhe mbylljen e procesit të likuidimit.

14.4. Pas pagimit të kreditorëve dhe shlyerjes së pjesëve të kapitalit themeltar tek kontribuesit përkatës, likuidatori ndan kapitalet e mbetura për Ortakun e Vetëm të Shoqërisë.

## **Neni 15 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve:**

15.1. Mosmarrëveshjet midis Ortakëve, Shoqërisë dhe të tretëve në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Tiranë, vendi ku ka selinë shoqëria.

## **KREU VIII DISPOZITA TË FUNDIT**

16.1. Për sa nuk është e parashikuar në këtë Statut, do t'i bëhet referim ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe legjislacionit në fuqi.

16.2. Ky Statut hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe dhe turke, secila me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë ligjore. Versioni shqip do të përdoret në çdo rast nga ana e gjykatës për përdorim zyrtar. Njëra prej kopjeve depozitohet në QKB dhe njëra prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të Shoqërisë.

**Asamblea e Ortakut të vetëm të Shoqërisë "DDS Global" Sh.pk :**

**Sema PEKIN**

---



**DHOMA E AVOKATISË TIRANË**

---

**Tirana Law Office – Frashëri Law Firm**

**Av. Kastriot FRASHËRI**

*Nr. 2593 Liçense*

**Tel:** + 355 68 60 00 067

**E-Mail:** [office@frasherilawfirm.com](mailto:office@frasherilawfirm.com)

**Adresa:** Rruga e Dibrës, Nd. 91, H. 4, Tiranë

Tirana, më 19. 10. 2023

**Our Ref:** \_\_\_\_\_/2023

**V È R T E T I M**

Ky Statut, u redaktua prej meje Av. Kastriot FRASHËRI, anëtar i Dhomës së Avokatëve të Shqipërisë, me Nr. 2593 License, me kërkesë të shtetases Sema Pekin, dhe bazohet në nenin 4 pika “c” të ligjit Nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, ju lexua dhe interpretua paleve nga unë avokati në gjuhën shqipe dhe u perkthye nga perkthyesi zyrtar i liçensuar në gjuhën turke, dhe pasi deklaroi se e kuptoj, e gjeti atë sipas vullnetit të saj të lirë dhe të plotë dhe më autorizoi mua avokatin me Prokurë Nr. 8555, datë 05.09.2023 për të nënshkruar atë lirisht.

**Av. KASTRIOT FRASHËRI**

# **“DDS Global” SHPK LİMİTED ŞİRKETİN TÜZÜĞÜ**

Bugün 19.10.2023 tarihinde, Edirne Merkez 23.02.1982 doğumlu, Ramiz'in kızı, Türk vatandaşı, Türkiye'deki “Şükrüpaşa Mah. Lefkoşa Sokak No.4, Ecem Residence Daire 46 Kat. 11, Edirne Merkez” adresinde ikamet eden, 15536263034 T.C. Kimlik Numaralı ve U298964441 numaralı Pasaportu, hareket etmek için tam yasal kapasiteye sahip olan ben Sema Pekin, özgür irademe dayanarak ve 14.04.2008 tarihli ve 9901 sayılı “Tüccarlar ve Ticaret Şirketleri Hakkında” Kanuna uyarınca Şirket tüzüğü hazırlamaya karar verdim:

## **BÖLÜM I ŞİRKET'İN AMACI, İSMİ, MERKEZİ VE YASAL REJİMİ**

### **Madde 1 Şirket'in amacı**

7. Şirket, Dış Ticaret, Uluslararası Gıda Ticareti, Eğitim Danışmanlığı ve Eğitimi, Avrupa Birliği Projeleri Danışmanlık Hizmetleri, Çeşitli Yazılım ve Uygulamaların Satın Alınması ve Tasarımı konularında gerekli her türlü ticari faaliyeti yürütecektir.
8. İhracat - İthalat. Perakende ve toptan mal alımları; komisyonculuk, eğitim kursları, seminerler ve konferansların organizasyonu; eğitim kursları, seminerler ve konferansların organizasyonu için teknik ve organizasyonel destek; reklam ve tanıtım faaliyetleri, ekonomik faaliyet ve organizasyon danışmanlığının yanı sıra pazar araştırmaları ve satış için destek hizmetlerinin yürütülmesi:
9. Şirket, eğitim, etkinlik, konferans, seminer ve sergi organizasyonu, küçük faaliyetlerin oluşturulması ve geliştirilmesi ile ilgili etkinliklerin yönetimi ve/veya alanlarında profesyonel hizmetlerin sağlanması ve satışı konusunda festivaller, konferanslar, törenler, resmi bayramlar, konserler, kongreler, iş danışmanlığı, ekonomik danışmanlık, çevre alanında danışmanlık gibi ulusal veya uluslararası ölçekte büyük bireylere ve iş ve kurumlara yönelik ve klasikleşmiş her türlü etkinlik gerçekleştirecektir.
10. Şirketin yukarıda belirtilen amacı ile doğrudan veya dolaylı bağlantısı olan ve iş alanında başka herhangi bir ticari faaliyetin gerçekleştirilmesi ve Arnavutluk'ta veya yurtdışında iş alanında herhangi bir ekonomik faaliyetin yürütülmesi ve gereken işin tanıtımı ve şirketin hedeflerine ulaşması.
11. Şirket yürürlükteki kanun ve mevzuatın izin verdiği diğer her türlü faaliyette bulunabilir.
12. Tek ortak, Şirketin Konusunu oluşturan faaliyetleri yürürlükteki mevzuatın izin verdiği sınırlar dahilinde değiştirmeye, eklemeye veya azaltılmaya karar verebilir.

### **Madde 2 Şirket'in Adı ve Merkezi**

- 2.1. Tek ortak, Şirkete “DDS Global” shpk adını vermeye karar verdi.

2.2. Şirket'in genel merkezi, Tiran'daki Njësia Administrative Nr.9, Rruga e Dibres, Nd.91, H.4, Kodi Postar 1017 adresinde geçici olarak olacaktır. Bu adres, Yönetim Kurulu'nun ilk toplantısına ve şirketin faaliyete geçmesine kadar kayıt amacıyla geçicidir.

**E-mail:** semapekin@hotmail.com

**Tel:** ++ 90 532 173 55 65

2.3. Şirket'in merkezinin devri Ortaklar Kurulu kararı ile yapılmaktadır.

2.4. Şirket, ihtiyaçları doğrultusunda Arnavutluk'un diğer şehirlerinde veya yurtdışında iş veya hizmet yeri, temsilcilik ofisi veya şube gibi ikincil birimler açabilir. Karar, Ortaklar Kurulu tarafından alınır.

### **Madde 3** **Yasal rejimi:**

3.1. Şirket, Limited Şirkettir. Şirketin faaliyeti Kuruluş Senedi, Tüzük ve Arnavutluk'ta yürürlükte olan mevzuat, 14.04.2008 tarihli ve 9901 sayılı "Tüccarlar ve Ticaret Şirketleri Hakkında" kanunun hükümlerine tabidir.

3.2. Tek Ortak, kararıyla, gelecekte Arnavutluk mevzuatına göre organizasyonu ve işleyişi için daha uygun tesislerin yaratılması durumunda Şirketin yasal rejimini değiştirebilir. Bu durumda ortak, Kuruluş Senedi ve Şirket Tüzüğünü uyarlayacak ve bunu yetkili Arnavutluk veya yabancı makamların Ticaret Siciline tescil ettirecektir.

3.3. Şirket, kanuna uygun olarak yetkili organa veya Ulusal Kayıt Merkezine tescil edildiği tarihten itibaren tüzel kişiliğe sahiptir.

3.4. Şirket, faaliyetinin yürütülmesi ve faaliyetin mali performansının sağlanması için gerekli tedbirlerin alınabilmesi amacıyla, yerli veya yabancı bankalarda ülke para biriminde veya herhangi bir para biriminde banka hesabı açar. Şirket Ortağı veya onun atadığı yönetici, imzalarının örneğini hesabın açıldığı bankalara yatırır ve hesap üzerindeki işlem veya bankacılık işlemleri, bankacılık kuralları veya şirketin kararına göre hesap sahibi tarafından yapılır.

3.5. Şirket'in kendisine ait amblemi ve mührü olacaktır. Şekli ve içeriği şirket yöneticisi tarafından belirlenir.

## **BÖLÜM II** **HAKLAR VE GÖREVLER, SÜRE**

### **Madde 4** **Şirket'in ve Ortak'ın Hakları:**

4.1. Şirket'in Arnavutluk topraklarında ve Arnavutluk dışında anlaşmalar yapma ve çeşitli sözleşmeler imzalama hakkı bulunmaktadır.

4.2. Şirket maddi ve entelektüel mülkiyet yaratma hakkına sahiptir.

4.3. Şirket, Arnavutluk veya yabancı mevzuata uygun olarak Arnavutluk'ta veya yurtdışında farklı şirket veya işletmelere ortak olarak katılma hakkına sahiptir.

4.4. Şirket üçüncü kişilere karşı yalnızca ve münhasıran yatırdığı sosyal sermayesi ile mal ve varlıkları ile sorumludur. Hiçbir durumda Ortağın kişisel yükümlülüklerinden sorumlu değildir ve Ortak, Şirket tarafından üstlenilen yükümlülüklerden kişisel sorumluluk taşımaz.

4.5. Ortak, Şirket'in üretim faaliyeti, planları ve Şirket'in bilanço, ekonomik hesaplar gibi gerçekleşme ve ticari projeleri ile ilgili tüm veri veya bilgileri alma hakkına sahiptir.

4.6. Ortak, Şirket'in zararlarını yalnızca ve Hisse Senedi'ne yaptığı katkıların değeri sınırına kadar üstlenir.

### **Madde 5 Süre**

5.1. Şirket'in süresi belirsiz bir süredir. Şirket, Ortaklar Kurulu kararıyla her zaman feshedilebilir.

## **BÖLÜM III ESAS SERMAYE, KOTALAR Madde 6**

6.1. Esas sermaye 100.000 (yüzbin Lek'tir) olup nominal değeri 100.000 ALL olan 1 kotaya bölünmüştür.

6.2. Esas sermayedeki payların dağılımı şu şekildedir: Sema Pekin, 1 kota ve tam olarak kotanın % 100'üne sahiptir. Kota sahibi, tek ortak niteliğini taşır.

6.3. Şirket'in sermayesi Tek Ortağın alacağı kararlara göre artırılabilir veya azaltılabilir. Sermayenin azaltılması, ortak tarafından sermayenin kendisine ait olan kısmı kadar karşılanır.

6.4. Bu sermaye kanunla belirlenen asgari tutardan az olamaz.

### **Madde 7 Esas sermayenin paylarının transferi:**

7.1. Sermayedeki paylar, Şirket'in ortakları ile şirkete dahil olmayan diğer kişiler arasında serbestçe devredilebilir.

7.2. Kurucu sermaye payları ortak/ortaklardan şirket dışında kalan üçüncü kişilere ancak tek ortağın/ortakların onayı ile devredilebilir.

7.3. Kotaların (payların) devri, varsa ortakların ön alım hakkına bağlıdır. Böyle bir durumda, sermaye kotalarını devredecek ortağın, diğer ortaklara geri cevaplı tavsiye mektubu ve/veya elektronik adresi (bundan sonra "Bildirim" olarak anılacaktır) aracılığıyla "Tebliğat Mektubu" ile aşağıdakiler için önceden bildirimde bulunması gerekir.

- (a) sunulan kotaların sayısı;
- (b) alıcının/yararlanıcının adı;
- (c) her bir fiyat teklifi için, her durumda nakit olarak veya diğer olası bedeller durumunda (takas, gönüllü tazminat, işlem ve bedel karşılığında başka herhangi bir transfer durumunda) nakit değer olarak belirlenen, mutabakata varılan fiyat veya tazminatsız devir durumunda devredilen nesnenin değeri;
- (d) ödeme yöntemleri;
- (e) "Ön alım hakkını" kullanmaya daveti. Kotayı devreden kişi ile alıcı/yararlanıcı arasında mutabakata varılan olası süreler ve koşullar, ön alım hakkını kullanacakları diğer ortaklar açısından bağlayıcı olmayacaktır. Ön alım hakkı, satışa sunulan sermaye paylarının tamamını ifade eder.

7.4. Ortakların, kotaları devreden ortağa ön alım hakkını kullanıp kullanmama niyetlerini bildirmek için Bildirimin alınmasından itibaren 30 (otuz) gün süreleri olacaktır.

7.5. Belirtilen süre içerisinde cevap vermemeleri halinde ön alım hakkından feragat etmiş sayılırlar. Teklifin birden fazla ortak tarafından kabul edilmesi durumunda, kotaları devreden ortağın sunduğu kotalar, aksine bir anlaşma olmadığı sürece, kabul eden ortaklara sahip oldukları kotalar oranında bölünecektir. Teklif sahibi hiçbir durumda ön alım hakkını kısmen kullanamaz.

8.6. Ön alım hakkının kullanılmaması durumunda ilanda sunulan kotalar, ilanda belirtilen fiyat üzerinden üçüncü kişilere devredilebilecektir.

## **BÖLÜM IV ORGANİZASYON, YÖNETİM VE ANA ORGANLAR**

### **Madde 8**

8.1. Şirket, yetkili kurum olan Ulusal Kayıt Merkezi'ne tescil edildiği tarihten itibaren tüzel kişilik kazanır.

8.2. Ticaret Şirketi'nin adı, amblemi, NIPT ve adresi, bu şirket tarafından düzenlenen ve üçüncü taraflara gönderilen tüm kanuni işlem ve belgelerde belirtilmelidir.

8.3. Şirket'in ana organları; Tek Ortak veya ileride oluşacaksa diğer Ortaklardan oluşan Ortaklar Kurulu ve Yönetici'dir.

### **Madde 9**

#### **Şirket'in Ortaklar Kurulu:**

Ortaklar Kurulu Şirket'in karar alma organıdır. Şirket'in en yüksek karar alma organı olan Şirket'in Tek Ortağı veya gelecekte olacaksa diğer Ortaklar ve kararları Şirket'in yürütme organları tarafından uygulanması zorunludur.

Ortaklar Kurulu'nun hak ve yükümlülükleri Tek Ortak tarafından kullanılır. Ortaklar Kurulu toplantıya çağırma hakkı Şirketin Tek Ortağı veya Yöneticiye aittir. Ortaklar Kurulu yazılı bildirim veya e-posta aracılığıyla bildirim yoluyla toplanır.

Yazılı mektup veya elektronik mesajla yapılacak bildirim, toplantının yeri, tarihi, saati ve gündemini içermeli ve Ortaklar Kurulu toplantısı için belirlenen tarihten en geç yedi gün önce tüm ortaklara gönderilmelidir.

### **Madde 9/1**

#### **Ortaklar Kurulu'nun Çağırması, Azami Sayı ve Kararlar:**

9.1. 1. Ortaklar Kurulu, mali yıl sonundan itibaren 6 (altı) ay içerisinde, yılda en az bir kez, bilançonun onaylanması, Yönetici/Yöneticilerin ve/veya (eğer atanmışsa) muhasebe uzmanının raporunun ve envanterinin onaylanması için toplanmaktadır.

9.1. 2. Genel Kurul, Yöneticinin makul görmesi halinde kendi inisiyatifiyle veya sermayenin en az %5'ini (yüzde beş) temsil eden ortaklardan bir veya birkaçının Yöneticiye yapacağı talep üzerine her zaman toplantıya çağrılabilir. Kurul şu şekilde çağrılır:

a) Cevabın iadesi ile birlikte tavsiye mektubu ile bildirim.

b) Faks, E-posta, Telefon vb.

c) Elektronik posta. Elektronik posta ile yapılan bildirim, bildirim başlangıcından itibaren 10 (on) takvim günü sonra tamamlanmış sayılır. Her bir ortağın bildirimi, bu senedin giriş bölümünde açıklanan ilgili adreslere gönderilir. Bildirim ortaklara en az 15 (onbeş) gün önceden gönderilecektir.

9.1. 3. Ortak, Ortaklar Kurulu tek başına veya özel vekâletname sahibi yetkili bir temsilci aracılığıyla temsil edilebilir ve yalnızca vekaletname ile temsil hakkını aldığı toplantıda görüşülecek konularda karar vermelidir.

9.1. 4. Kurul toplantıları bu vesileyle tutulan tutanaklara yansıtılırken, kararlar tek ortak tarafından imzalanır.

Toplantı tutanakları Şirket'in merkezinde dosyalanır ve saklanır.

Ortaklar Kurulu tarafından alınan tüm kararlar, verileri değiştirilemeyen, düzeltilemeyen veya silinemeyen bir kararlar kaydına kaydedilir.

9.1. 5. Ortaklar Kurulu toplantılarında, yöneticileri tarafından uygun görülen davalarda, Batı uygulamalarını da göz önünde bulundurularak, onların isteği üzerine karara bağlanırsa, Şirket idaresinde Kurul üyesi, genel sekreter olarak ya da dış danışman rollerini yerine getirecek bir avukat kabul edilebilir. Bu kişi, yönetim kuruluna kurulun misyonunu, yetki ve sorumluluklarını, oluşumunu, toplantıların ne zaman yapılacağını ve toplantı tutanaklarının nasıl yazılacağını ve onaylanacağını anlatmalıdır. Ayrıca Şirket'in ihtiyaçları için gerekli belgelerin veya kanun değişiklikleri de dahil olmak üzere belirli alanlardaki düzenleyici kanunlar için gerekli bilgilerin hazırlanması konusunda yardım sağlayacaktır.

Avukatın bu yapıya dahil olması için davet, şirket yöneticisi aracılığıyla yapılmaktadır. Bu durumda uygulanan standart oranlara göre katılım karşılığında ödüllendirilir.

**9. 1. 6. Şirketin Tek Ortağı veya Ortaklar Kurulu aşağıdaki konularda karar alma hakkına sahiptir:**

- a) Şirketin ticari politikalarının belirlenmesi.
- b) Tüzükteki değişiklikler.
- c) Yöneticinin atanması ve görevden alınması.
- ç) Tasfiye memurları ve yetkili muhasebe uzmanlarının atanması ve görevden alınması.
- d) Bu maddenin “c”, “ç” ve bentlerinde belirtilen kişilerin maaş veya ikramiyelerinin belirlenmesi.
- dh) Yıllık mali tabloların ve faaliyet ilerleme raporlarının hazırlanması da dahil olmak üzere ticari politikaların uygulanmasının Yöneticiler tarafından denetlenmesi.
- e) Yıllık mali tabloların ve faaliyet ilerleme raporlarının onaylanması.
- ë) Sermaye artırımı ve azaltımı.
- f) Kotaların dağıtımı ve iptali.
- g) Şirketin mahkemelerde ve yöneticiler aleyhine açılan diğer davalarda temsil edilmesi.
- g) Şirketin yeniden düzenlenmesi/birleşmesi/ayrılması ve feshi.
- h) Genel Kurul toplantılarının usul kurallarını onaylanması.
- i) Kanun veya tüzükte öngörülen diğer hususlar.

## **BÖLÜM V** **ŞİRKET’İN YÖNETİMİ** **Madde 10**

10.1. Şirket, 1 (Şirket Ortakları dışından seçilebilecek tek bir Yönetici) tarafından yönetilecektir.

10.2. Yönetici, şirketin tek ortağı veya ortaklar kurulu tarafından atanır ve görevden alınır.

10.3. Şirketin yönetimi, Yönetici olan Sema Pekin tarafından gerçekleştirilecektir.

10.4. Şirket yöneticisinin görev süresi 5 (beş) yıl olacak ve görev süresinin bitiminde yenileme hakkı bulunacaktır.

10.5. Tek yönetici, Şirket’in hedeflerine ulaşabilmesi için olağan yönetime ilişkin tüm haklara, yetkilere sahiptir.

10.6. Yönetici, üçüncü şahıslarla ilişkilerde şirketi temsil eder.

10.7. Yönetici, duruma göre Şirket’e veya üçüncü şahıslara karşı yalnızca yasaların ihlali, Tüzük ihlali veya görevlerini yerine getirirken meydana gelen zararlardan sorumludur.

10.8. Şirket’te yöneticinin başlıca yetkileri şunlardır:

- Tek Ortak tarafından belirlenen ticari politikaları uygulayarak Şirket'in ticari faaliyetinin günlük yönetimine ilişkin tüm eylemleri gerçekleştirmesi.
- Ticari Şirketi üçüncü şahıslarla ilişkilerde temsil etmesi.
- Şirket'in evraklarının ve Şirket'in muhasebe defterlerinin doğru ve düzenli tutulmasına özen göstermesi.
- Yıllık bilançoyu, konsolide bilançoyu ve faaliyet ilerleme raporunu hazırlayıp imzalaması ve kâr dağıtım teklifleriyle birlikte bu belgeleri Tek Ortağa onay için sunması.
- Faaliyetin sorunsuz yürümesini ve Şirket'in varlığını tehdit edebilecek risk ve durumlara karşı doğru zamanda güvenlik ve uyarı sistemi oluşturması.
- Ulusal Kayıt Merkezi'ne kanunda öngörüldüğü şekilde kayıtları gerçekleştirme ve Şirket'in zorunlu verilerini göndermesi.
- Ticari politikaların uygulanmasına ve Ticaret Şirketi'nin faaliyetleri için özel öneme sahip özel eylemlerin uygulanmasına ilişkin olarak, duruma göre Tek Ortağa veya Ortaklar Kurulu huzurunda sunulan raporlaması.
- Kanun ve tüzükte tanımlanan görevleri yerine getirmesi.
- Ortaklar Kurulu veya Tek Ortak tarafından izin verilen sınırlar dahilinde, ekipman ve aletler dahil olmak üzere Şirket mülklerinin ve mali gelirin idare etmesi.
- Şirket yararına tüm bankacılık işlemlerinin yürütülmesi.
- Tüm faaliyetlerinde üçüncü kişilerle olan ilişkilerde sınırlama olmaksızın Şirket'i temsil etme ve her türlü mahkeme veya tahkim, kamu idaresi önünde menfaatlerini koruma, Şirket adına yetkileri dahilinde her türlü sözleşmeyi imzalama ve bunların uygulanmasını takip etmesi.
- Yönetici, belirli eylemleri gerçekleştirmek veya şirketin çıkarlarını temsil etmek ve korumak için özel yasal temsilciler görevlendirebilmesi.
- Şirket'in idari yapısını ve Şirket'in faaliyet ve hedeflerinin gerçekleştirilmesi için gerekli diğer organların oluşturulmasını Tek Ortak'a onay için teklif etmesi.
- Şirket'in çalışanların sayısını, maaşlarını, atanmalarını ve işten çıkarılmalarını Tek Ortak'a onay için teklif etmesi.
- Sunulan herhangi bir durum için Ortaklar Kurulu'nun her an kendi inisiyatifiyle toplanmasına çağrıda bulunması.

## **Madde 11**

### **Yasaklanan Anlaşmalar**

11.1. Yöneticinin veya Ortağın hiçbir şekilde sözleşme yapmasına, Şirket'ten kredi almasına, Şirket adına avanslar için muvafakat vermesine ve aynı zamanda kendi adına üçüncü şahıslara kefil olmasına veya taahhütleri garanti etmesine izin verilmez. Aksi takdirde sözleşme geçersizdir. Bu yasaklayıcı tedbir, ortakların tüzel kişi olan yasal temsilcileri hakkında da uygulanır.

11.2. Bu tedbir aynı zamanda bu maddenin birinci fıkrasında belirtilen kişilerin eşleri, ataları ve altsoyunları ile aracı kişiler için de geçerlidir.

## **BÖLÜM VI**

### **MALİ YIL, YILLIK HESAPLAR, KÂR PAYLAŞIMI**

## **Madde 12**

12.1. Her mali yıl 1 Ocak'ta başlar ve 31 Aralık'ta sona erer. Bunun istisnası, Şirket'in Ulusal Kayıt Merkezine tescil edildiği tarihte başlayan ilk yıldır.

12.2. Mali yılın yıllık hesapları, envanteri, raporları ve işlemleri, yönetici ve en sonunda yetkili muhasebe uzmanı tarafından hazırlanan özel raporlar, 14.04.2008 tarihli ve 9901 sayılı "Tacirler ve ticari şirketler için" Kanunu'nun gerektirdiği çoğunluk ile Ortaklar Kurulu tarafından onaylanmaktadır.

12.3. Yıllık faaliyete ilişkin belgelerin onaylanması mali yılın sonundan itibaren 3 ay içinde gerçekleşir.

12.4. Yıllık bakiyeden elde edilen kâr, ortaklara sahip olunan sermaye payları oranında dağıtılır.

12.5. Kurul, olağanüstü yedek akçeler lehine veya başka amaçlarla özel indirimler yapabilir veya kârın, temettülerin dağıtımının tamamen veya kısmen gelecek mali yıllara ertelenmesine karar verebilir.

## **Madde 13**

### **Şirket'in Kontrolü**

13.1. Şirket'in denetimi Ortaklar Kurulu tarafından atanan Yetkili Muhasebe Uzmanı tarafından gerçekleştirilir.

13.2. Yetkili Muhasebe Uzmanı, Şirket'in yıllık hesaplarının düzenli olduğunu, samimiyetle düzenlendiğini, bir önceki mali yılın sonuçlarını ve şirketin mali durumunu yansıttığını garanti eder. Şirket'in hesap defterlerinin yanı sıra fonlarını da doğrular, muhasebenin verilerle ve yönetim raporuyla ayarlanmasını kontrol eder, tüm hesap defterlerini, muhasebe belgelerini ve tutanak kayıtlarını kontrol eder. İş yoğunluğuyla başa çıkmak için diğer uzmanları ve işbirlikçileri harekete geçirebilir, ancak önce Ortaklar Kurulu'nun onayını almalıdır.

13.3. Yetkili Muhasebe Uzmanının görevden alınmasına, Ortaklar Kurulu tarafından atanması ile aynı şartlarda karar verilir.

## **BÖLÜM VII**

### **ŞİRKETİN BOZULMASI VE TASFİYESİ**

#### **Madde 14**

14.1. Şirket, iflas, ticari faaliyette bulunma haklarının yoksunluğu, mücbir sebepler ve Ortağın kontrolü dışındaki diğer faktörler gibi herhangi bir zamanda ve herhangi bir nedenle feshedilebilir.

14.2. Şirket, infisah anından itibaren tasfiye aşamasına girer. Bu süreci yürütmek için Ortaklar Kurulu bir veya daha fazla tasfiye memuru atar ve bu memurlar kendisine Şirket'in aktif ve pasiflerinin durumu, Likidite işlemlerinin takibi ve işlemleri tamamlanması için gerekli son tarih hakkında rapor sunar.

14.3. Tasfiye sürecinin sonunda Ortaklar Kurulu, nihai mali dengeye, tasfiye memurunun çalışmalarının düzenliliğine ve tasfiye sürecinin kapatılmasına karar vererek karar verir.

14.4. Tasfiye memuru, alacaklılara ödeme yapıp hisse sermayesini ilgili katılımcılara geri ödedikten sonra kalan sermayeyi Şirket'in Tek Ortağına dağıtır.

### **Madde 15** **Anlaşmazlığın Çözümü:**

15.1. Ortaklar, Şirket ve üçüncü taraflar arasındaki anlaşmazlıklar, dostane bir şekilde çözülmediği takdirde, bunların çözümü için şirketin merkezinin bulunduğu yer olan Tiran Bölge Mahkemesi yetkili olacaktır.

## **BÖLÜM VIII** **NİHAİ HÜKÜMLER**

16.1. Bu Tüzükte aksi belirtilmediği sürece 14.04.2008 tarihli ve 9901 sayılı "Tacirler ve ticari şirketler için" Kanunu'na ve yürürlükteki mevzuat atıf yapılacaktır.

16.2. Bu Tüzük Arnavutça ve Türkçe her biri aynı içerik ve hukuki değere sahip 4 (dört) nüsha halinde düzenlenmiştir. Arnavutça versiyonu her durumda mahkeme tarafından resmi kullanım için kullanılacaktır. Bir nüshası Ulusal Kayıt Merkezi'nde bir nüshası ise Şirketin esas evraklarında muhafaza edilir.

### **"DDS Global" Sh.p.k Şirketi'nin Tek Ortağı Kurulu:**

**Sema PEKIN**

**DHOMA KOMBËTARE**  
**E AVOKATISË SË SHQIPËRISË**



**NATIONAL CHAMBER**  
**OF ADVOCACY OF ALBANIA**

---

**DHOMA E AVOKATISË TIRANË**  
**Tirana Law Office – Frashëri Law Firm**  
**Av. Kastriot FRASHËRI**

Nr. 2593 Linçense

**Tel:** + 355 68 60 00 067

**E-Mail:** office@frasherilawfirm.com

**Adres:** Rruga e Dibrës, Nd. 91, H. 4, Tiranë

Tiran, 19. 10. 2023

**Our Ref:** \_\_\_\_\_/2023

## **BELGE DOĞRULAMASI**

İşbu Kuruluş Senedi, Ulusal Noterler Odasında üyesi olan, 2593 sayılı ruhsata sahip olan benim Avukat Kastriot FRASHËRI tarafımdan vatandaş Sema Pekin'dir talebi üzerine ve 55/2018 sayılı "Arnavutluk Cumhuriyeti'nde avukatlık mesleđi hakkında" Kanunu'nun 4. maddesinin "c" bendi esas alınmıřtır. Avukat olarak tarafıma Arnavutça okundu ve resmi lisanslı yeminli tercüman tarafından Arnavutçadan Türkçeye çevrilmiřtir. Anladığını beyan ettikten sonra kendi özgür ve tam iradesiyle bulunmuş olan 05.09.2023 tarihli ve No 8555 sayılı Özel Vekaletname ile bana serbestçe imzalamama tam yetki vermiřtir.

**Avukat KASTRIOT FRASHËRI**